

VENDIM
Nr. 45, datë 13.6.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 30, DATË 18.7.2017 “PËR LICENCIMIN E
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT-KUÇOVË”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe Rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a., për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”;
 - Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 630 prot., datë 25.5.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik;
 - Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit teknik, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Drejtuesi teknik plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e licencimit.
- Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtuese teknike: Aleksandra Kllapi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani